



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.shk.II.nr.1387/2023**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjiellit “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli ne Prishtine, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson kompania e avokateve “Arberesh” me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.659/22, të datës 26.05.2023, me datë 01.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pathemeltë** ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjiellit “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.659/22, të datës 26.05.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.659/22, të datës 26.05.2023, e ka aprovuar si të bazuar propësimin e debitorit Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli ne Prishtine, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson kompania e avokateve “Arberesh” me seli ne Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Valdrin Beka P.nr.534/21 të dt.29.03.2021, andaj ka shfuqizuar urdhrin e përmbarimor.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimorë P.nr.534/21 të dt.29.03.2021, ndërkaq propësimin e debitorit ta refuzoi në tërësi, apo t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitore.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, me datë 26.02.2021, ka paraqitur propozim për përbarim, kundër debitorit debitorit Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli ne Prishtine, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga libri i kontabilitetit per periudhën 01.01.2013 deri me 24.03.2021, për prestimin e pakryer, ne shumën prej 654.94 euro, si dhe te gjitha shpenzimet e procedurës permbarimore.

Përbaruesi privat Valdrin Beka, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.534/21 të dt.29.03.2021, ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitorit me datë 12.04.2021, ka ushtruar prapësim duke theksuar se nuk ka date specifike për cilën periudhe është borxhi, nuk janë te përshkuara shërbimet qe janë objekt i faturës, e as periudha kohore per përmbushjen e detyrimit si dhe nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhe kohore është grumbulluar borxhi ne fjale, me tej debitorit ne kundërshtimet e tij ka theksuar se ekstraktit nga libri i kontabilitetit ne rastin konkret nuk përbenë dokument përbarues, si dhe për faktin se borxhi është i parashkruar, andaj i propozon gjykatës qe te aprovoj kundërshtimet si në prapësim.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, me dt.16.04.2021, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përbarimi duke theksuar se debitorit nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim te nenit 71 te LPP qe te aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.659/22, të datës 26.05.2023 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr. 534/21 të dt.29.03.2021, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim të dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga libri i kontabilitetit per periudhën 01.01.2013 deri me 24.03.2021, për prestimin e pakryer, ne shumën prej 654.94 euro, mbi bazë të së cilës përbaruesi privat e ka lejuar përbarimin, por ky dokument nuk përben bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përbarimor, e po ashtu nga shiqimi ne ketë dokument rezulton se nuk janë te përshkuara shërbimet qe janë objekt i faturës, e as periudha kohore per përmbushjen e detyrimit si dhe nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhe kohore është grumbulluar borxhi ne fjale. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktit nga libri i kontabilitetit per periudhën 01.01.2013 deri me 24.03.2021, ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-Se. E po ashtu edhe gjykata e shkallës së dyte, pajtohet ne tërësi me qëndrimin juridik te gjykatës se shkallës se parëse ky dokument nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**Kom.Dh.shk.II.nr.1387/2023, me datë 01.03.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami, d.v.**